

Hapet thirrja për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin e Humboldt-Universität zu Berlin, në Gjermani.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Humboldt-Universität zu Berlin, në Gjermani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime ose hulumtim për tezën e tyre;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor (nuk mund të aplikojnë dot studentët e vitit të parë Bachelor);
- Master;
- Doktoraturë;

Kohëzgjatja e bursave:

- Studentët e nivelit Bachelor (1 semestër);
- Studentët e nivelit Master dhe Doktoraturë (1 semestër);

Fushat e studimit:

- Shkenca Humane;
- Gjuhë të Huaja dhe Shkenca Filologjike;
- Histori;
- Arkeologji dhe trashgimni kulturore;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti;

- Dokumenti i aplikimit që mund ta shkarkoni në adresën https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-application-form-for-mobility-grant-new.pdf/at_download/file

-Listë notash (në shqip si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi (në gjuhën angleze);

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Gjermanisht niveli B2, në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit); Ose në mungesë të saj plotësoni dokumentin Language Assessment Sheet. Per ta shkarkuar këtë dokument vizitoni:

https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-language-certificate-2016.docx/at_download/file

-Learning Agreement*

* *Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Ju mund të shkoni në universitetin pritës edhe për të bërë hulumtime dhe për të shkruar tezën tuaj të Bachelor. Kini parasysh që teza mbrohet në UT.

Dokumenti “*Learning Agreement*” tek seksioni “*Commitment*” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e *Learning Agreement* klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Dokumenti i aplikimit që mund ta shkarkoni në adresën https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-application-form-for-mobility-grant-new.pdf/at_download/file
- Dipolma e Bachelor;
- Listë notash bachelor (në shqip si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash master (në shqip si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi (në gjuhën angleze);

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Gjermanisht niveli B2, në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit); Ose në mungesë të saj plotësoni dokumentin Language Assessment Sheet. Për ta shkarkuar këtë dokument vizitoni:

https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-language-certificate-2016.docx/at_download/file

-Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Ju mund të shkoni në universitetin pritës edhe për të bërë hulumtime dhe për të shkruar tezën tuaj të Masterit. Kini parasysh që teza mbrohet në UT.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Doktoraturë:**

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit;

- Dokumenti i aplikimit që mund ta shkarkoni në adresën https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-application-form-for-mobility-grant-new.pdf/at_download/file

- Dipolma e Bachelor;

- Listë notash bachelor (në shqip si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

- Diploma e Master-it;

- Listë notash master (në shqip si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi (në gjuhën angleze);

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Gjermanisht niveli B2, në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit); Ose në munges të saj plotësoni dokumentin Language Assessment Sheet. Per ta shkarkuar këtë dokument vizitoni:

https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-language-certificate-2016.docx/at_download/file

- Përshkrim të projektit PhD dhe plan të punës për periudhën shkencore të studimeve;

- Letër paraprake pranimi nga një supervizor në universitetin pritës;

- Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Ju mund të shkoni në universitetin pritës edhe për të bërë hulumtime

dhe për të shkruar dizertacionin tuaj. Kini parasysht që dizertacioni mbrohet në UT.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikime: 10 Nëntor 2017

Dokumentat duhen dorzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në UT në adresën: iro@unitir.edu.al ose të vizitoni:

<https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/colabnet/erasmus/era-students>

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!